

Intervistë e Kreut të Prezencës së OSBE-së, Ambasadorit Pavel Vacek, me revistën “Klan”

4 nëntor 2006

Zoti Vacek, këtë javë ju mbushni dy vjet në detyrën e kreut të Misionit të OSBE-së në Shqipëri. Duke u kthyer pak mbrapa në kohë, përpara se të mbërrinit në Shqipëri, si e prisnit atë dhe a ju doli ky vend ashtu siç e prisnit?

“Kam mësuar se gjërat nuk janë shpesh ashtu si duken... Pritshmëritë? Njeriu mund të ketë shumë pritshmëri, por në një farë mënyre ato janë më pak të rëndësishme se sa përmbushja e premtimeve dhe planeve. Prezenca ka pasur sukses në një aspekt të rëndësishëm: në atë kohë, ne kemi mundur të kanalizojmë më shumë burime në vend se sa kurrë më parë. Kemi qenë më pak të suksesshëm për t’u larguar nga ndërmjetësimi politik i proceseve të reformave në vend – jo sepse nuk do të kishim dashur, por sepse kërkesa për këtë nga pala shqiptare ekziston ende”.

Duke marrë shkas paksa nga eksperiencia jo pak e vështirë e paraardhësit tuaj, ditën kur ju ngarkuan detyrën e kreut të Prezencës, morën ndonjë paralajmërim mbi vështirësitë që ju prisnin me politikën e një vendi kaq të vogël si Shqipëria?

“Po, në dhanë disa këshilla miqësore. Ajo që kam filtruar nga këshilla të tilla ka qenë, pak a shumë, gjithmonë kjo: ji i paanshëm, mos i lejo të tjerët të instrumentalizojnë atë për të cilën je mandatuar dhe mos e lejo veten të bëhesh pjesë e lojërave politike”.

Gjatë këtyre dy viteve që kanë kaluar, mund të na veçoni se cili ka qenë momenti juaj më i vështirë në marrëdhëniet me politikën shqiptare?

“Ka pasur disa momente gjatë ndërmjetësimit politik... sepse kur të thonë se ta kanë nevojën, ndjen se ke një detyrim. Megjithatë, në të njëjtën kohë, di se çdo ndërhyrje e tillë e vonon ardhjen e momentit kur vendi të jetë i aftë t’i zgjidhë vetë probleme të tilla”.

A është e vështirë të jesh ndërmjetës asnjëanës mes dy kraheve kryesorë politikë në vend? Kujtoj këtu, se keni ndërmjetësuar në arritjen e marrëveshjes së fundit mes PS dhe PD, e cila sërish duket e bllokuar.

“Po, është gjithmonë e vështirë të jesh i paanshëm dhe megjithatë është akoma më e vështirë të qëndrosh i paanshëm dhe të perceptohesh nga të tjerët si i tillë. Zgjidhja e ngërçeve të tilla duhet të jetë gjithmonë përgjegjësi e përfaqësimit politik shqiptar dhe jo e bashkësisë ndërkombëtare”.

Disa prej politikanëve shqiptarë, me kohë janë shprehur kundër Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Madje, e kanë cilësuar atë si të tepërt, duke kritikuar shpesh punën dhe rolin e saj. Si do t’i përgjigjeshit këtyre qëndrimeve?

“Unë u përgjigjem vetëm argumenteve të arsyeshme... Dhe, nëse ndihmon, mund të përsëris që Prezenca nuk do të jetë këtu përgjithmonë, ne gradualisht do të tërhiqemi dhe unë e di pikëpamjen e qeverisë lidhur me këtë. Por a e keni vënë re se largimi i Prezencës kërkohet zakonisht në çastin kur këshillat tona nuk i shkojnë për shtat axhendës politike të atij personi ose partie? Por ma merr mendja se kjo është pjesë e punës”.

Zoti Neritan Ceka apo dhe zoti Skënder Gjinushi, nuk i kanë përmbajtur së fundmi, deklaratat e tyre kundër jush. Madje, kanë shkuar më tej duke e cilësuar OSBE si “zyrë turizmi” ndërsa ju, si një “kryeturist”. Cili është roli i OSBE dhe a po e kryen plotësisht rolin e saj ajo?

“Unë nuk dua të merrem me fyerjet... Por nëse ju doni fakte, po i radhis ato më poshtë: Prezenca nxit demokratizimin, shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut, si dhe ndihmon në konsolidimin e institucioneve demokratike. Në veçanti, mbështet ndërtimin e kapaciteteve të Kuvendit. Ajo ofron ndihmesë në reformën zgjedhore, gjyqësore, legjislative dhe atë të pronave, mbështet Policinë e Shtetit dhe autoritete të tjera në luftën kundër korrupsionit dhe trafikëve. Në përgjithësi, Prezenca nxit qeverisjen e mirë përmes forcimit të shoqërisë civile, përfshi këtu zhvillimin e medias së pavarur dhe standardeve profesionale.

Në fushën e bashkëpunimit për sigurinë, ne kemi trajnuar mbi 1000 oficerë policie për luftën kundër trafikëve, ruajtjen e kufirit dhe çështje të rolit të policisë gjatë procesit zgjedhor. Prezenca ka siguruar, gjithashtu, ekspertizë për ligjin e ri të policisë së shtetit dhe për menaxhimin e integruar të kufirit, dhe, në veçanti, siguroi pajisje për ruajtjen e kufirit si dhe gjeneratorë me panele diellore për pikat e kalimit kufitar. Ajo ka mbështetur edhe takime ndër-kufitare me homologët e policive fqinje.

Ne ndihmojmë në fushën e qeverisjes së mirë për çështjet ekonomike dhe mjedisore dhe, për shembull, përfunduar regjistrimin fillestar të dhjetëra mijëra pronave. Kohët e fundit, ne kemi rënë dakort me qeverinë që të përqendrohemi në çështjen e ndërtimeve të paligjshme për të ndihmuar në procesin e legalizimit. Ne kemi mbështetur procesin e kthimit dhe kompensimit dhe institucionet e këtij procesi, duke ndihmuar në hartimin e legjislacionit dhe sigurimin e pajisjeve teknike.

Ne kemi mbështetur, gjithashtu, qeverinë për krijimin e një kodi etike që përfshin rregulla kundër shfrytëzimit ekonomik dhe seksual të fëmijëve në industrinë e turizmit. Prezenca drejtoi një projekt për të rinjtë e papunë në qytetet veriore, duke nxitur kështu fuqizimin e tyre ekonomik. Në fushën e qeverisjes vendore, ne kemi ndihmuar në përmirësimin e procesit të konsultimit me publikun për ta bërë atë më transparent. Kemi nxitur një ndërgjegjësim më të madh për çështjet e mjedisit dhe bashkëpunimin me autoritetet dhe shoqërinë civile. Ne ndihmuam, gjithashtu, krijimin e Qendrës Aarhus në Shqipëri për nxitjen e të drejtës së publikut për informacion që ka lidhje me çështjet e mjedisit.

Mendoj se është tashmë e ditur që ne ndihmuam në hartimin e të gjitha zonave zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2005. Drejtuam edhe një projekt për përmirësimin e regjistrimit të zgjedhësve, ndërsa Raporti Përfundimtar i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet

përmendi një saktësi më të lartë të listave zgjedhore. Tani, jemi duke u përgatitur për punë edhe më të mëdha për të ndihmuar në modernizimin e gjendjes civile dhe sistemit të adresave.

Prezenca ka komentuar gjerësisht për legjislacionin që ka lidhje me çështje të policisë, ato gjinore dhe të mbrojtjes së dëshmitarit. Ne kemi trajnuar mbi 100 gjykatës për çështje të etikës dhe të drejtësisë për të miturit. Kemi analizuar edhe funksionimin e gjykatave, kemi siguruar rekomandime për qeverinë, dhe kemi punuar për t'i bërë qytetarët të ndërjegjshëm për të drejtat e tyre.

Në punën tonë me Kuvendin, ndihmuam në hartimin e rregullores së re për të forcuar rolin e Kuvendit si mbikëqyrës i punës së qeverisë, organizuam seminare për deputetët dhe siguroam pajisje teknike për të përmirësuar aksesin e publikut.

Ne punojmë me shoqërinë civile dhe mbështesim një qendër këshillimi për gratë në Kukës, në veri të Shqipërisë, për të nxitur të drejtat e grave. Ne kemi mandat për të punuar edhe me median. Kemi rishikuar dhe përgatitur legjislacion mbi median, kemi ndihmuar në krijimin e Këshillit për Etikën në Media, rifreskuar Kodin e Etikës për gazetarët dhe kemi ndihmuar Fakultetin e Gazetarisë në Universitetin e Tiranës me një plan të ri për programin shkollor dhe strategji për punën e tyre.

Pra, siç mund ta shihni, Prezenca është duke punuar me partnerët tanë shqiptarë për të realizuar reforma thelbësore. Unë nuk kam kohë për të humbur për t'iu përgjigjur kritikave të pajustificuara që vijnë nga ata njerëz që, historikisht, kanë mbajtur të njëjtin qëndrim”.

Sipas jush, ka ndonjë arsye pse politikanë të caktuar reagojnë kështu ndaj Prezencës së OSBE në Shqipëri?

“Ndoshta këtë pyetje duhet t’jua bëni atyre...”

Është e qartë se Shqipëria ende nuk e ka kaluar krizën politike që e përfshiu korrikun e kaluar. Për disa, OSBE-ja duhet të kishte ndërhyrë më shpejt në zgjidhjen e kësaj krize. Sipas jush, a ndodhemi në një krizë politike dhe nëse po, cila do të ishte zgjidhja?

“Nuk më takon mua të gjykoj. Ne ofruam ndihmesë jozyrtare për problemet më imediate të reformës zgjedhore dhe përgatitjes së zgjedhjeve. Pjesa tjetër i takon përfaqësimit politik shqiptar”.

Ndryshe nga paraardhësi juaj, ju nuk preferoni të shfaqeni aq shumë në media dhe të bëni deklarata publike. Por përherë keni zgjedhur të jeni më tepër institucional. Përse keni vendosur të ndiqni një rrugë të tillë? Apo është në natyrën tuaj?

“Ndoshta kjo varet nga metoda, karakteri i personit apo stili. Ose ndoshta është një mënyrë tjetër për të treguar se unë nuk dua të ndërhyj në politikën vendase”.

E gjitha kjo, a mos ka të bëjë me një “paralajmërim” le të themi, se OSBE nuk do ta ketë më rolin e saj vendimtar në Shqipëri? Pra, se prania e sa mund të ulet mjaft?

“Sigurisht, do të zvogëlohet me kalimin e kohës. Ky zvogëlim gradual i rolit dhe i përmasave duhet të bazohet në dëshirën e përbashkët të vendeve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe, sigurisht, të vendit pritës. Instrumentet kryesore janë mandati dhe buxheti, të cilat miratohen me konsensus”.

Politika shqiptare është një ngrënëse e mirë e kohës. Por, atë pak kohë të lirë që keni, si e kaloni në Tiranë?

“Unë përpiqem ta kaloj pjesën më të madhe të kohës së lirë me sport. Së fundmi, lexoj më pak se sa do të doja... muzikë dëgjoj vetëm nga CD-të”.

Po familja dhe fëmijët... a janë ambientuar ndopak me këtë jetë të re të tyre? Ju nuk jeni me ta në pjesën më të madhe të kohës...

“Nuk kam familje ose fëmijë. Kjo, sigurisht, ma bën punën më të lehtë, por e bën jetën private më të cekët”.